

VENDIM
Nr. 377, datë 26.12.2023

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “METODOLOGJISË MBI
PËRCAKTIMIN E DETYRIMIT PËR ENERGJINË E RINOVUESHME”**

Në mbështetje të nenit 16, pika 8, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme”; të nenit 19, germa “b”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe të neneve 19 dhe 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.12.2023, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2527 prot., datë 26.12.2023, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e Metodologjisë për përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme për t’u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Metodologjia ka për qëllim të përcaktojë përlllogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme për t’u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike, sikurse përcaktuar në ligjin nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet rinovueshme”.

- Akti i hartuar është i përberë nga tre pjesë (dispozita të përgjithshme, metodologjia për llogaritjen e detyrimit të energjisë së rinovueshme dhe dispozita të fundit) dhe ka në tërësi 14 nene.

- Në pjesën e tretë të metodologjisë, përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e Operatorit të Energjisë së Rinovueshme (OER) dhe ERE-s (neni 4), furnizuesve të energjisë elektrike (neni 5), parashikimi vjetor i energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi (neni 6), llogaritja e detyrimit për energjinë e rinovueshme (neni 7), faturimi dhe pagesa e detyrimit për energjinë e rinovueshme dhe mbështetjen për prodhuesit me përparësi (neni 8), rregullat e detyrimit të energjisë së rinovueshme (neni 9) si dhe kufiri maksimal për instrumentet afatshkurtër për likuiditet nga furnizuesit dhe nga OER-ja (neni 10).

- Në dispozitat kalimtare, metodologjia ka përcaktuar rishikimin e jashtëzakonshëm kur ka një devijim të tepruar ndërmjet vlerave të parashikuara dhe të realizuara për qëllimin e llogaritjes së detyrimit për energjinë e rinovueshme, sipas neneve 7 dhe 9, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes palëve kontraktuale, rishikimin dhe ndryshimin e metodologjisë dhe hyrjen në fuqi të saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e “Metodologjisë mbi përcaktimin e detyrimit për energjinë e rinovueshme për t’u paguar nga konsumatorët fundorë të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas publikimit në Fletoren Zyrtare.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Petrit Ahmeti